



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1877 Prot.

Roskovec, më 28.04 2020

VENDIM

NR 22 .DATË 27.04 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN MARS 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 27.03.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 1619/11 Prot.

Roskovec, më 27.03.2020

Procesverbal Nr.3

-I mbajtur sot, date 27.03.2020, ora 10, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise. Mbledhja e sotme po zhvillohet ne zbatim te Aktit Normativ Nr.3 date 15.03.2020 te Keshillit te Ministrave neni 5, per shkak te gjendjes se jashtezakonshme qe po kalon vendi nga perhapja e virusit COVID-19. Kjo mbledhje po zhvillohet nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik, online permes video konferences ne skype. Rendi i dites se mbledhjes :

1. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-29 Shkurt 2020.
2. Për dhënie ndihma ushqimore për familjet në nevojë dhe miratimin e destinacionit të përdorimit për subvencionin për ujësjellës-kanalizime Roskovec Sh.a për vitin 2020 (603).
3. Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2021-2023.
4. Për miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec.
5. Për miratimin e Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike.
6. Për miratimin e Kodit të Sjelljes dhe të Parandalimit të Konfliktit të Interesave të këshilltarit bashkiak"

Pjesemarrja online e keshilltareve: Mungon online Vjollca Bakaj, Lumturi Hoxha, Elmazi dhe Hekurani votuan me telefon, Viktori me imeil. Gjithe te tjeret jane online ne skype.

Me plotesimin e kuorumit te keshilltareve online, kryetari I keshillit hap mbledhjen. Prezent online permes mjeteve te komunikimit elektronik jane 19 keshilltare. Ne salle ndodhen Kryetari i Keshillit, Sekretarja e Keshillit dhe punonjes mbeshtetes te IT se bashkise te cilet asistojne per zhvillimin e kesaj mbledhje online. Kryetari falenderon te gjithe keshilltaret per bashkepunimin dhe gadishmerine e treguar nga anetaret ne kete situatë te veshtire. Hedh ne votim rendin e dites dhe miratohet unanimisht online me 19 vota pro. Elmazi, Hekurani votuan me telefon, Viktori votoi me imeil.

1. Per dhenien e Ndhmes Ekonomike nga fondi I kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-29 Shkurt 2020.

Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht online me 19 vota pro.

2.Per dhenien ndihma ushqimore per familjet ne nevoje dhe miratimin e destinacionit te perdorimit per subvencionin per ujesjelles-kanalizime Roskovec sh.a per vitin 2020 (603).

Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro online.Leksi-ne jemi te gjithë dakort per kete materjal sepse jane ndihma per njerzit ne nevoje ne kete suate te veshtire.Bujari-cili i ka nxjere familjet ne nevoje,kryepleqt apo ndonje komision?Nenkryetari sqaron projektin dhe pyetjen e Bujarit,subvencioni do te perdoret per paga dhe blerje klori.Per ndihmat ushqimore jane percaktuar kategorite perfituese nga qeveria.Ne kemi ngritur grup pune dhe kemi bere verifikime shtepi me shtepi,kane plotesuar edhe formularet.Hidhet edhe njehere ne votim pas sqarimeve te bera dhe miratohet edhe nje here perseri unanimisht me 19 vota pro online.

3.Per miratimin e tavaneve te shpenzimeve per programin buxhetor afatmesem 2021-2023.

Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht online me 19 vota pro.

4.Per miratimin e Rregullores se funksionimit te Keshillit te Bashkise Roskovec.

Hidhet ne votim projekti i Rregullores se funksionimit dhe miratohet unanimisht online me 19 vota pro.

5.Per miratimin e Rregullores se Keshillit Bashkiak per konsultimet publike.

Hidhet ne votim projekti i rregullores se konsultimeve publike dhe miratohet unanimisht online me 19 vota pro.

6.Per miratimin e kodit te sjelljes dhe te parandalimit te konfliktit te interesave te keshilltarit bashkiak.

Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht online elektronikisht me 19 vota pro.

Kryetari i Keshillit I falenderon te gjithë keshilltaret per miratimin e pikave te rendit te dites edhe ne kete suate.Edhe kryetarja e bashkise i falenderon dhe i uron nga zemra keshilltaret per kete model qytetarie qe treguan sot,dhe gadishmerine ne marrjen e vendimeve ne interes dhe sherbim te komunitetit.Uron qe te jene te gjithë mire nga kjo suate.Kryetari mbyll mbledhjen.

Shenim:Elmazi,Hekurani votuan me telefon,Viktori votoi me imeil,te tjeret ne skype.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska